

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Diana Sina, me bashkëpunëtorin profesional Njazi Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. J. nga fshati S., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2-1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr. 774/2015, të datës 21.10.2015, jashtë shqyrtimit, më datën 01.07.2016, mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa për dhënien e Urdhrit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr. 774/2015, të datës 21.10.2015, Gjykata i shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të akuzuarit:

A. J., nga i ati I., e ëma D., e lindur G., i lindur me ..., në Gjakovë, tani me banim ne fsh. S., Komuna e Gjakovës, i pa martuar, bujk, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, nr. ID..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 15.05.2015, rreth orës 12:15 min, në fshatin S. Komuna e Gjakovës, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë, që pas mosmarrëveshjes paraprake që i dëmtuari kishte me të pandehurin rreth shfrytëzimit të një livadhi të cilin ia kishte dhënë me qesim, derisa i dëmtuari ishte duke u kthyer në shtëpi, i pandehuri afër shtëpisë së tije e sulmon me thikë të dëmtuarin D. J. duke e goditur në dorën e djathtë, me të cilat veprime i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore sipas mendimit te ekspertit mjeko-ligjor të Dr. F. D., te dt. 30.06.2015.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2-1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 3,4,41,43,46,73, dhe 188 par. 2-1 të KPRK-së, si dhe nenit 493 dhe 495 të KPPK-së, Gjykata i shqipton:

D Ë N I M M E G J O B Ë

Në shumën prej treqind (300) Euro, të cilin është e detyruar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

I dëmtuari: D. J. nga fsh. S., Komuna Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor prej 20 € si dhe shpenzimet e ekspertit mjeko ligjore në shumën prej 20 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.774/2015, të datës 21.10.2015, duka ja vënë në ngarkim të akuzuarit A. J., për shkak të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par. 2-1 të KPRK-së, ka kërkuar që të nxirret Urdhri ndëshkimor dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë.

Duke shqyrtuar propozimin e prokurorit për dhënien e Urdhrit ndëshkimorë, Gjkata gjeti se është i bazuar në kuptim te nenit 493 dhe në bazë të nenit 495 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas aktakuzës, të akuzuarit i vihet në ngarkim vepra penale e lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par. 2-1 të KPRK-së, për të cilin është paraparë dënim me burgim deri në tre (3) vjet.

Provat e shqyrtuara:

- Raporti fillestar i incidentit 2015-EA-802, dr. 15.06.2015;
- Deklarata e viktimës D. J., dhënë në S. P. Gjakovë më datë 15.06.2015;
- Deklarata e të dyshuarit A. J., dhënë në S. P. Gjakovë më dt. 15.06.2015;
- Intervista marrja ne pyetje e të pandehurit A. J., dhënë më dt. 15.06.2015;
- Raporti i oficerit B. T., dt. 15.06.2015;
- Foto albumi;
- Lista e armëve të konfiskuara, dt. 15.06.2015;
- Raport i shkurt, dt. 15.06.2015;
- Spitali Rajonal "Isa Grezda" Reparti i Emergjencës, për D. J., dt. 15.06.2015;
- Thika 2015-EA-802, dt. 15.06.2015;
- Mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. D., për D. J..

Gjykata gjene se këto prova ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e Urdhrit ndëshkimor duke u bazuar në nenin 495 të KPPK-së, sepse të njëjtat vërtetojnë se e akuzuara në kohë, vend dhe mënyrë të përshtuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par. 2-1 të KPPK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit konform nenit 73 të KPPK-së, Gjykata mori parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryesit, e të gjitha këto me bindjen se dënimi i shqiptuar do të arrijë efektin ndëshkimor.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit që për kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil, bazohet në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor dhe të shpenzimeve të ekspertizës mjeko ligjore është marr bazuar në nenin 450 paragrafi 1 dhe 2 nën-paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.659/15, më datën 01.07.2016

Bashkëpunëtori profesional:
Njazi Morina

G J Y Q T A R J A:
Diana Sina

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë kundërshtim në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjyqtares individual të kësaj Gjykate.